



**VJETORI I POLICISË SË KOSOVËS
GODIŠNJICA POLICIJE KOSOVA
ANNIVERSARY OF THE KOSOVO POLICE**



Policia e Kosovës

Mesazhi i
Drejtorit të PK-së
Faqe 3

Struktura
Faqe 4-5

Historiku i Policisë
së Kosovës
Faqe 6-7

Misioni, vizioni dhe vlerat
e Policisë së Kosovës
Faqe 8

Drejtorja për Planifikim dhe
Vlerësim Operacional
Faqe 10

Drejtorja e Policisë në
Bashkësi dhe Parandalim
të Krimit
Faqe 11

Njësia Speciale
Intervenuese
Faqe 12

Njësia për Trajtimin e
Mjeteve të Improvizuara
Eksploduese
Faqe 13

Njësia Speciale
Operative
Faqe 14

Njësia për Mbrojtje të Afërt
Faqe 15

Njësia Speciale
me qen K-9
Faqe 16

Drejtorja për
sigurimin e objekteve dhe
personaliteteve
Faqe 17

Njësia për mbrojtjen e
trashëgimisë
kulturore-fetare
Faqe 17



Përmbajtja

Departamenti për Operacione
FAQE 10

Departamenti për Kufi
FAQE 27

Departamenti për Hetime
FAQE 29

Departamenti për Shërbime
Mbështetëse
FAQE 31

Departamenti i Burimeve njerëzore
FAQE 32

Detyrat dhe përgjegjësitë
E divizionit të
komunikacionit rrugor
Faqe 18

Drejtorja Rajonale e
Policisë – Prishtinë
Faqe 19

Drejtorja Rajonale e
Policisë – Gjilan
Faqe 20

Drejtorja Rajonale e
Policisë – Pejë
Faqe 21

Drejtorja Rajonale e
Policisë – Ferizaj
Faqe 22

Drejtorja Rajonale e
Policisë – Prizren
Faqe 23

Drejtorja Rajonale e
Policisë – Gjakovë
Faqe 24

Drejtorja Rajonale e
Policisë - Mitrovicë- Jug
Faqe 25

Drejtorja Rajonale e
Policisë - Mitrovicë – Veriu
Faqe 26

Drejtorja për Bashkëpunim
Ndërkombëtar në Fushën e
Zbatimit të Ligjit
Faqe 33

Zyra për informim dhe
marrëdhënie me publikun
Faqe 34

Katalogu i uniformave
zyrtare të Policisë
së Republikës së Kosovës
Faqe 35

Informator për Policinë e Kosovës

Botues: ZIMP: Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun e PK-së - DPP - Prishtinë

Kryeredaktor: Baki Kelani, **Redaktor:** Brahim SADRIU, Luljeta Mehmeti-Quigley

Dizajni: Çajup KAJTAZI, **Lektor:** Leonora FEJZULLAHU - RUHANI

E-mail: zimp@kosovopolic.com

www.kosovopolic.com

20 VJETORI I POLICISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Rashit QALAJ

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ditët e para të paraqitjes zyrtare të zyrtarëve policorë me uniformat e Policisë së Kosovës nëpër qytetet e Kosovës janë pamjet me të bukura dhe të paharrueshme në memorien e secilit banor të Kosovës sepse ato kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë sinonimi i lirisë dhe sigurisë për secilin banor të Kosovës

Të nderuar

Kam nderin dhe kënaqësinë që me rastin e 20 vjetorit të themelimit të Policisë së Kosovës si drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës të paraqesë para juve këtë revistë prezantuese të Policisë së Kosovës.

Këtë vit ne festojmë 20 vjetorin e themelimit dhe pa dyshim që është një vit jubilar dhe i rëndësishëm për secilin pjesëtar të Policisë së Kosovës por edhe për gjithë popullin e Kosovës, miqtë tanë strategjike që nëpër vite na kanë përkrahur dhe na kanë ndihmuar për të arritur synimet tona strategjike dhe për të ardhur këtu ku jemi.

Gjithë këto vite dhe kjo rrugë nëpër të cilën kemi kaluar nuk ka qenë e lehtë. Kemi kaluar nëpër shumë sfida dhe vështirësi por edhe sukseset nuk kanë munguar asnjëherë.

Si një nga institucionet e para në Kosovë pa dyshim së nuk ka qenë e lehtë sepse qytetarët na janë drejtuar për çdo shqetësim të tyre edhe nëse ato nuk kanë qenë në domenin e punës policore, por ne jemi munduar të jemi gjithmonë me qytetarin në mbrojtje dhe në ndihmë të secilit banor të Kosovës.

Ditët e para dhe zyrtarët policorë me uniformat e Policisë së Kosovës nëpër qytetet e Kosovës janë pamjet më të bukura dhe të paharrueshme në memorien e secilit banor të Kosovës sepse ato kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë sinonimi i lirisë dhe sigurisë për secilin banor të Kosovës.

Krejt kjo punë për gjithë këto vite ka bërë që Policia e Kosovës të renditet sot një nga institucionet më të besuara dhe më kredibile në vend. Policia e Kosovës ka arritur që nëpër vite të shtrihej bashkëpunimin edhe

në arenën ndërkombëtare dhe të jetë partner shumë i besuar dhe kredibil për të gjitha organizatat ndërkombëtare policore me të cilat ajo sot bashkëpunon.

Sot përveç që ofrojmë siguri për banorët e Kosovës ne jemi partnerë dhe të renditur krah policive më të mëdha demokratike për luftimin e veprimtarive kriminale dhe kërcënimeve globale me karakter ndërkombëtar dhe transnacional. Duke ua uruar 20 vjetorin e themelimit të Policisë së Kosovës secilit punonjës të Policisë, shfrytëzoj rastin që në emër të Policisë së Kosovës të falënderoj të gjithë ata që kanë kontribuar që nga dita e parë e deri më sot në nderimin e kapaciteteve të Policisë me bindjen se Policia e Kosovës nuk do t'i zhgënjejë kurrë qytetarët dhe partnerët e saj.

Urime dhe suksese në të ardhmen.

Historiku i Policisë së Kosovës

Me 6 shtator të vitit 1999, Misioni i OSBE-së në Kosovë, ka hapur Shkollën e Policisë dhe ka filluar trajnimin e kandidatëve për pjesëtarë të Policisë së Kosovës, me synim që të krijojë një forcë moderne policore, e cila do të kthejë besimin tek zbatuesit e ligjit dhe në mënyrë efikase të zbatojë parimet e kryerjes së detyrave policore në bashkëpunim me komunitetin. Gjenerata e parë e kandidatëve për pjesëtarë të këtij shërbimi filloi trajnimin në këtë qendër me 6 shtator 1999.

Kjo gjeneratë numëroi 176 pjesëtarë, të cilët me sukses përfunduan trajnimin dhe pastaj filluan ushtrimin e veprimtarisë policore në tërë territorin e Kosovës, si policët e parë të këtij shërbimi.

Kosova për herë të parë në historinë e vet, me ndihmën e faktorit ndërkombëtar krijoi Policinë në përputhje me strukturën nacionale të popullsisë në Kosovë. Detyrat, përgjegjësitë dhe funksionet e policisë vendore të themeluar sipas autoritetit të UNMIK-ut, në mënyrë graduale janë transferuar nga data 15 qershor 2002. Shërbimit Policor të Kosovës

iu shtua mbështetja institucionale me themelimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme me 25 dhjetor 2005. Shërbimi Policor i Kosovës u krijua në bazat e një policie demokratike dhe profesionale, një shërbim i hapur dhe i barabartë për të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të bëhen pjesëtarë të këtij shërbimi. Trajnimi në Shkollën e Policisë së Kosovës është një trajnim me standarde të larta, duke përfshirë: detyrat patrulluese, taktikat mbrojtëse, përdorimi i forcës, ndihma e parë, kodi i etikës policore, legjislatura e aplikueshme në Kosovë, hetimi i krimit, grumbullimi i evidencave dhe metoda e intervistave, politika demokratike dhe fokusimi në besueshmërinë e rregullave të ligjit demokratik, përdorimi i armëve të zjarrit, forenzika dhe evidenca, kontrolli i trafikut etj. Pas përfundimit të trajnimit me sukses në Shkollën e Policisë së Kosovës, trajnim i cili është zgjatur në vazhdimësi dhe tani është 22 javor, pjesëtarët e këtij shërbimi vazhdojnë me programin e trajnimit fushor në stacionet policore, me trajnerë të certifikuar. Ky trajnim gjithashtu është zgjatur në

vazhdimësi dhe tani është 2 vjet derisa zyrtarët policorë bëhen të pavarur. Gjatë rekrutimit bëhen përpjekje të përzgjedhin meshkuj dhe femra nga rajonet endryshme, të cilët pasqyrojnë lloj-llojshmërinë etnike e kulturore të Kosovës. Nga viti 1999 deri në vitin 2010 Policia e Kosovës ka operuar sipas strukturës organizative të dizajnuar nga stafi ndërkombëtar dhe lokal dhe në vitin 2012 përfundimisht është hartuar struktura organizative e Policisë së Kosovës e aprovuar nga ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Kosovës. Aktivitetet sipas strukturës organizative aktuale të Policisë së Kosovës koordinohen në dy nivele të organizimit: niveli qendror dhe lokal (përfshirë atë rajonal). Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është niveli qendror përgjegjës për tërë Republikën e Kosovës. Niveli lokal përfshin Drejtoritë Rajonale të Policisë, përgjegjëse për rajonet e përbëra me komunat e caktuara, stacionet policore që janë përgjegjëse për policinë lokale në secilën komunë dhe nënstationet policore – përgjegjëse për policinë lokale brenda zonave të caktuara të një komune. Pas shpalljes së pavarësisë





së Kosovës me 17 shkurt 2008 u krijuan rrethanat e reja për krijimin e institucioneve të Republikës së Kosovës, e në kontekst të kësaj edhe krijimi i Policisë së Republikës së Kosovës. Policia e Kosovës ka ngritur kapacitetet profesionale në parandalimin, hetimin e krimit, mbrojtjen dhe sigurinë publike,

konform rrethanave dhe situatës së krijuar, mbështetur në vizionin, misionin dhe vlerat e këtij shërbimi, do të përmbushen duke qenë të përkushtuar dhe përgjegjës, komunikativë dhe transparentë, të paanshëm dhe seriozë në kryerjen e detyrave gjithnjë në shërbim të komunitetit. Policia e

Kosovës i kushton rëndësi fuqizimit të bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare dhe ka për synim anëtarësimin në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare. Një nga elementet kryesore të bashkëpunimit është edhe zgjerimi i kontakteve ekzistuese por edhe ndërtimi i kontakteve të reja.



MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT E POLICISË SË KOSOVËS

Misioni

Të ofrojë siguri dhe shërbime për të gjithë personat në Kosovë bazuar në ligj, praktikat më të mira dhe standardet e policimit demokratik.

Policia e Kosovës do të përmbushë misionin duke:

- Ofruar siguri publike (sigurinë e jetës dhe pronës);
- Mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut;
- Bashkëpunuar me komunitetin dhe institucionet;
- Kontrolluar dhe mbikëqyrur kufirin;
- Përmirësuar performancën e organizatës;
- Parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe format tjera të aktiviteteve kriminale.

Vizioni

“Policia profesionale, e trajnuar, e pajisur mirë, efikase në ofrim të sigurisë, në zbatim të ligjit, parandalimit dhe luftimit të krimit, duke qenë shembull në rajon, gjithnjë në mbështetje dhe besnike ndaj komunitetit.

Vlerat

Lidershipi: çdo zyrtar është përgjegjës për t'u dëshmuar si shembull dhe me dedikim personal pavarësisht ku punon.

- Orientimi ndaj shërbimit: secili zyrtar kontribuon në kualitetin e jetës ndaj komunitetit që i shërben.
- Integriteti: ne do të punojmë me drejtësi, ndershmëri dhe sinqeritet, gjithnjë bazuar në standardet më të larta etike dhe morale.
- Dedikimi: vigjilent dhe pro-aktiv në organizatë dhe komunitet, i vetëmotivuar dhe kreativ.
- Puna ekipore: puna ekipore është esenciale për arritjen e suksesit. Në ekip duhet të kyçen edhe zyrtarët nga brenda po ashtu edhe komuniteti, për arritjen dhe përmbushjen e objektivave strategjike.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE SPECIFIKE

1. Ofrimi i sigurisë publike dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarë;
2. Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve të rënda si dhe terrorizmit;
3. Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit shtetëror;
4. Avancimi i menaxhimit të burimeve njerëzore;
5. Standardizimi i infrastrukturës fizike, teknike dhe i teknologjisë informative.

Departamenti për Operacione

Misioni i Departamentit të Operacioneve është zbatimi profesional, etik dhe i ligjshëm i detyrave dhe autorizimeve të Policisë së rendit, gjatë patrullimit, hetimit dhe shërbimit të aktivitete tjera policore, dedikuar detyrës për shërbim ndaj qytetarëve, ruajtjes së rendit, parandalimit dhe zbulimit të veprimeve të kundërligjshme dhe zbulimit të kryerësve të tyre.


Departamenti i Operacioneve e përkrah dhe mbështet Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në realizimin e synimeve dhe objektivave strategjike për organizatën. Në këtë aspekt ky autoritet zbaton dhe nxjerr vendime, urdhëron planifikime, udhëheq operacione policore, kërkon aktivitete dhe detyra konkrete për njësitet vartëse në nivel qendror dhe lokal, bashkëpunon dhe koordinon me institucionet tjera të sigurisë, në operacione të veçanta të sigurisë së përgjithshme.

Departamenti i Operacioneve kujdeset për zbatim të drejtë të autorizimeve të përgjithshme policore dhe përmbushjen e objektivave strategjike të Policisë së Kosovës, konkretisht:

1. të mbrojë jetën, pronën dhe të ofrojë siguri për të gjithë personat
2. të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave
3. të parandalojë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike
4. të parandalojë dhe t'i zbulojë veprat penale dhe kryerësit e tyre
5. të mbikëqyrë dhe të kontrollojë sigurinë në komunikacion
6. të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët pa dallim race, ngjyre, religjioni, gjinie dhe moshe
7. të kryejë funksione të ndihmës dhe shërbimeve për qytetarët
8. të ofrojë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente.



Divizioni për Siguri Publike ka në strukturën e tij Drejtorinë për Planifikim dhe Vlerësim Operacional dhe Drejtorinë e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë



Drejtoria për Planifikim dhe Vlerësim Operacional

Kjo drejtori ka për detyrë planifikimin dhe koordinimin operativ të të gjitha njësive policore në kuadër të këtij departamenti, hartimin e planeve dhe urdhrave operativë policorë për raste të caktuara, menaxhimi dhe mbikëqyrja e situatave të ndryshme, po ashtu hartimin e procedurave të operimit të cilat duhet të jenë në harmoni me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Detyrë parësore e njësive vartëse të këtij departamenti është mbrojtja e rendit dhe qetësisë publike parandalimi dhe luftimi i kriminalitetit të të gjitha llojeve, bashkëpunimi i ngushtë me qytetarët dhe faktorët tjerë relevantë etj.



Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim të Krimit

Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim të Krimit në Strukturën Organizative PK-së është e sistemuar në Departamentin për Operacione, gjegjësisht në Divizionin e Sigurisë Publike. Zanafilla e veprimeve policore për komunitetin në aspektin e konceptit filozofik “Policimi në Komunitet” fillon që nga viti 2001-2002. Struktura organizative e asaj kohe ishte në secilin stacion policor të ketë së paku nga një zyrtar policor dhe sipas nevojës edhe dy ose tre zyrtarë policorë, varësisht nga numri i popullatës në atë zonë të përgjegjësisë. Në vitet që pasojnë Policia e Kosovës çdo ditë e më shumë zhvillon dhe formëson veprimtarinë e vet dhe zhvillon, avancojnë konceptin filozofik dhe praktik të “Policimit në Komunitet”, duke zhvilluar qasjen e saj përmes trajnimeve të

shumta bashkë me komunitetin dhe duke përshtatur veprimtarinë e vet, duke u bazuar në thënien “Policia është Populli dhe Populli është Policia”. Vizioni dhe misioni i kësaj drejtorie është: të hartojë, të zhvillojë, të implementojë dhe të hartojë politika strategjike me qëllim të shtrirjes së “veprimeve të orientuara policore në komunitet”, në ndërtimin dhe avancimin e partneritetit me komunitetin, duke zhvilluar bashkëpunimin, me qëllim të identifikimit, dhe zgjidhjen e problemeve, shqetësimeve dhe brengave të komunitetit, të cilat janë të lidhura me jetën dhe mirëqenien e qytetarit. DPBP-ja

brenda vetes ka të sistemuar tre sektorë: Sektori për programe dhe projekte, Sektori për delikuencë të të miturve dhe Sektori për bashkëpunim me forume të sigurisë.





*Divizioni i Njësive të Specializuara
ka në strukturën e tij Drejtorinë
e Njësive të Specializuara dhe
Drejtorinë për Sigurimin e Objekteve
dhe Personaliteteve*

NJËSIA SPECIALE INTERVENUESE

Njësia Speciale Intervenuese, është njësi elite, e aftësuar dhe e trajnuar për të intervenuar në detyrat apo operacionet speciale policore, të vlerësuara me nivel rreziku të lartë apo ekstrem. Detyrat parësore të kësaj njësie janë: lirimi ose shpëtimi i pengjeve, ndjekja dhe arrestimi i kriminelëve me rrezikshmëri të lartë apo ekstreme, neutralizimi i të dyshimtëve të rrezikshëm në rastet e përdorimit të armëve të zjarrit (gjuajtësve aktivë, në progres) ku janë të involvuar qytetarët e pafajshëm, ofrimi i përkrahjes për NJMA-në në përcjellje të VIP me rrezikshmëri ekstreme me Ekipin Kundër Sulmues.





Njësia për Trajtimin e Mjeteve të Improvizuara Eksploduese

Është njësi elite e Policisë së Kosovës, ku detyrë primare e kësaj njësie është: reagimi në rastet e kërcënimeve me bombë, trajtimi, neutralizimi dhe çmontimi i të gjitha bombave të ndërlidhura me rastet kriminale dhe terroriste, ku kryhet hetim kriminal nga Policia. Hetimi pas shpërthimit, ndihma në rikonstruimin e mjetit shpërthyes dhe mbledhja e ruajtja e dëshmive, kontrollimet antiterroriste kur rrezikshmëria është e lartë dhe ekstreme e lartë, mbështetja teknike-operative për operacione speciale NJSI, NJMA dhe NJSO (kontrollimet anti-terroriste për mbrojtjen e personave me rëndësi të veçantë VIP), trazira publike etj.





Njësia Speciale Operative

Është njësi elite e Policisë së Kosovës, ku detyrë primare e NJSO-së është kontrollimi dhe menaxhimi i turmave, si: protestave, demonstratave, grevave dhe të gjitha tubimeve publike, por edhe detyra tjera si:

- Arrestimet dhe bastisjet e personave të rrezikshëm;
- Sigurimi i manifestimeve kulturore-sportive;
- Përcjellja të personave të dyshuar me rrezikshmëri;
- Sigurimi i seancave gjyqësore;
- Zbatimi i urdhërave të DPP në mbështetje të njësive dhe stacioneve policore, kur ka çrregullim të rendit publik.





Njësia për Mbrojtje të Afërt

Kjo njësi funksionon në kuadër të Divizionit të Njësive të Specializuara dhe në nivel operativ mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Njësia për Mbrojtje të Afërt është krijuar në fillim të vitit 2002, është e trajnuar me standarde bashkëkohore dhe detyrë primare e ka sigurimin e personaliteteve me rëndësi të veçantë VIP, vendorë dhe ndërkombëtarë. Po ashtu në kuadër të kësaj njësie ka pjesëtarët që kryejnë ekstradime në vende të ndryshme.





Njësia Speciale me qen K-9

Kjo njësi funksionon në kuadër të Drejtorisë së Njësive Speciale, në nivel operativ mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës. Është krijuar në vitin 2002 dhe është e trajnuar dhe e specializuar për:

- Zbulimin e lëndëve narkotike
- Zbulimin e mjeteve të dyshuara eksplozive dhe armëve
- Patrullimin, gjurmimin, kapjen e personave të dyshuar, gjetjen e mjeteve të dyshuara. Njësia K-9 ka në dispozicion raca të ndryshme të qenve zyrtarë si: Malinas, Pastor gjerman, Springer spanjoll, Pastor belg.



Drejtoria për Sigurimin e Objekteve dhe Personaliteteve



Kjo drejtori ka për detyrë sigurimin e objekteve të Krëndësisë së veçantë, siç janë: objektet e Presidencës, Kuvendit të Kosovës, Qeverisë dhe objektet e ambasadave të akredituara në Kosovë.

Njësia për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore-fetare

Konjësi kapërdetyrë sigurimin e të Gjitha objekteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare në vend. Gjatë punëve ditore të kësaj drejtorie përfshihen aktivitetet e sigurisë permanente të disa objekteve fetare dhe sigurimin e kohëpaskohshëm të disa objekteve.





DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E DIVIZIONIT TË KOMUNIKACIONIT RRUGOR


Polica e Kosovës (PK) ofron sigurinë në komunikacionin rrugor përmes njësive të tyre të specializuara, për ofrimin e sigurisë në komunikacionin rrugor, të cilat koordinohen nga ana e Divizionit të Komunikacionit Rrugor. Ky divizion, i cili vepron nën ombrellën e Departamentit për Operacione, përbëhet nga dy drejtori në nivel qendror: Drejtorinë për Siguri dhe Mbikëqyrje të Komunikacionit Rrugor dhe Drejtorinë për Preventivë në Komunikacionin Rrugor dhe gjashtë (6) Njësiti Rajonale të Komunikacionit Rrugor në nivel lokal. Njësia e motoçikletave vepron në kuadër të NJRKRR-ve, në periudhën kohore të sezonit veror, saktësisht prej 15 mars deri me datën 15 nëntor, në përputhje me standardet e operimit me motoçikletë.

Me lëshimin në qarkullim të autostradës së Kosovës është krijuar Njësia për Kontroll të Autostradave, e cila funksionon në kuadër të Divizionit të Komunikacionit Rrugor.

Të gjitha njësitet e Divizionit të Komunikacionit Rrugor, kanë për detyrë zbatimin e ligjit të

komunikacionit rrugor, si dhe ligjeve tjera në fuqi, mbikëqyrja dhe siguria në komunikacionin rrugor. Hetimi mbi aksidentet e komunikacionit ku ka lëndime të rënda ose vdekje, brenda zonave urbane dhe ndaj të gjitha aksidenteve jashtë zonave urbane. Patrullimi me qëllim parandalimin e aksidenteve në komunikacionin rrugor në të gjitha rrugët e vendit, orientimi dhe siguria si dhe përcjellja e personaliteteve vendore dhe ndërkombëtare.





Drejtoria Rajonale e Policisë - Prishtinë

DRP e Prishtinës ka një shtrirje territoriale prej 2.140.82 km² dhe me një popullsi multi-etnike prej 470.583 banorë. Në kuadër të DRP-së Prishtinë punojnë stacionet policore, 'Qendra' në Prishtinë, 'Jugu' në Prishtinë, 'Veriu' në Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Graçanicë, dhe Njësia e Trafikut Rajonal me lokacion në Fushë Kosovë. Numri i punonjësve në këtë DRP është 1100 punonjës zyrtarë policorë. Si karakteristikë e cila e veçon këtë DRP është fakti se Prishtina është kryeqyteti i Republikës së Kosovës. DRP e Prishtinës mbulon territorin e shtatë komunave: Prishtinë, Podujevë, Drenas, Lipjan, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë. Prishtina si kryeqytet i Republikës së Kosovës është qendër e zhvillimeve diplomatike, kulturore dhe artistike e të gjithëve

që jetojnë në Kosovë. Në zonën e përgjegjësisë së DRP-Prishtinës janë objektet e rëndësishme të veçantë, si: Parlamenti i Republikës së Kosovës, Presidenca, Qeveria me të gjitha ministrat, komanda e KFOR-it, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Komanda e FSK-së, ambasadat dhe zyrat diplomatike, Ombudspersoni, Gjykata Kushtetuese dhe gjykatat tjera, Prokuroria e Shtetit, organizatave joqeveritare, Qendra Universitare Spitalore, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, termocentralet, objektet religjioze, objekte të rëndësishme kulturore dhe shkencore, si: Biblioteka Kombëtare dhe Universitare, Universiteti i Prishtinës, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Teatri Kombëtar, Pallati i Rinisë dhe Sporteve, qyteti i studentëve me të gjitha konviktet e studentëve etj.



Drejtoria Rajonale e Policisë - Gjiçan

Drejtoria e Rajonale e Policisë në Gjiçan në kuadër të strukturimit të saj ka stacionet policore në Gjiçan, Kamenicë dhe Viti, Novobërdë, Kllokot, Partesh dhe Ranilluk dhe nënstacionet në fshatrat Zhegër, Pozhoran dhe Muqivërc. Numri i përgjithshëm i punonjësve të PK-së në këtë DRP është mbi 600 punonjës zyrtarë policorë dhe staf civil. Zona e përgjegjësisë së DRP-së së Gjiçanit ka sipërfaqe 1505 km katrorë dhe përafërsisht ka rreth 188188 banorë, ku numri më i madh i tyre janë të përkatësisë etnike shqiptare, pastaj serbë dhe të nacionaliteteve tjera, si: turq, boshnjakë, romë etj.



Drejtoria Rajonale e Policisë - Pejë


Drejtoria e Rajonale e Policisë në Pejë, në kuadër të strukturimit të saj ka stacionet policore në Pejë, Istog, Klinë, Deçan, Junik, dhe nënstationet në fshatrat Vitomiricë dhe Gorozhdec. Zona e përgjegjësisë së DRP-së në Pejë ka sipërfaqe 1735 km katrorë, 280 fshatra dhe përafërsisht ka rreth 371.770 banorë, ku numri më i madh i tyre janë të përkatësisë etnike shqiptare, pastaj edhe të nacionaliteteve tjera, si: serbë, boshnjakë, romë etj.






Drejtoria Rajonale e Policisë - Ferizaj

Zona e përgjegjësisë së DRP- Ferizaj ka sipërfaqe prej 1018 km dhe ka 185,695 banorë. Në kuadër të kësaj drejtorie punojnë stacionet policore në Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpçë, Hani i Elezit. Karakteristikë e kësaj drejtorie është se në zonën e përgjegjësisë së kësaj drejtorie është rruga magjistrale që karakterizohet me trafikimin më të madh në vend, rruga që lidh dy kryeqytetet Prishtinën dhe Shkupin.



Drejtoria Rajonale e Policisë - Prizren

Zona e përgjegjësisë së kësaj drejtorie ka sipërfaqe prej 2.024 km² me një popullatë prej rreth 387.828 banorë me përkatësi etnike të përzier shqiptarë, turq, boshnjakë, serbë: komuniteti RAE, goran etj. Kjo masë e popullatës është e shpërndarë në gjashtë qytete që mbulojnë në total 233 fshatra. Në kuadër të DRP – Prizren punojnë stacionet policore në Prizren, Malishevë, Rahovec, Suharekë, Mamushë, Dragash dhe nënstacionet në fshatin Sreskë, Zhur, Mushtisht, Krushevë, Njësia e Trafikut Rajonal.






Drejtoria Rajonale e Policisë – Gjakovë

Zona e përgjegjësisë së Drejtorisë Rajonale në Gjakovë apo territori i saj është i përcaktuar sipas ndarjes që ka gjyqësori ekjopërfshin komunën e Gjakovës, të Rahovecit dhe të Malishevës. Kjo hapësirë e zë pjesën jugperëndimore të Kosovës. Ky rajon ka specifikat e veta duke filluar nga madhësia që është 1109 km², me 165 fshatra dhe tri qytete, me rreth 205.377 banorë, me pozitën e saj gjeografike dhe objekte të rëndësisë së veçantë. Kjo drejtori rajonale ka nën përgjegjësi këto stacione policore: Stacionin Policor të Gjakovës, Rahovecit dhe Malishevës.



Drejtoria Rajonale e Policisë - Mitrovicë- Jugu

Kjo drejtori ka zonë të përgjegjësisë rreth 1050 km², me numër të përgjithshëm 192600 banorë dhe mbulon territorin e tri komunave: Mitrovicë e Jugut, Skenderaj dhe Vushtrri. Në kuadër të DRP-Mitrovicë operojnë tri stacione policore: Stacioni Policor Mitrovicë Jugu, Vushtrri dhe Skenderaj ndërsa tri nënstacione policore janë në: Syriganë, Frashër dhe Prelluzhë.





Drejtoria Rajonale e Policisë - Mitrovicë - Veriu

Kjo drejtori ka në strukturën e saj katër stacione policore dhe tri nënstacione policore. Stacioni policor Mitrovicë-Veriu, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq dhe nënstacionet policore në Çabër, Bistricë dhe Lip. Kjo drejtori ka katër qytete dhe 176 fshatra. Ka popullatë me përkatësi etike të përzier.



Departamenti për Kufi

Në kuadër të këtij departamenti janë të strukturuar dy divizione dhe pesë drejtori dhe stacioni policor i aeroportit. Në të gjithë vijën kufitare të Kosovës janë gjithsej 16 pikëkalime kufitare 13 punojnë 24/7 ditë në javë ndërsa tri janë pikëkalime të përkohshme. Puna kryesore e këtij departamenti është sigurimi i

pacenueshmërisë së kufirit shtetëror, parandalimi, zbulimi dhe hetimi i krimit ndërkufitar. Në kuadër të divizionit të kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit janë të strukturuar: Drejtoria Rajonale e Veriut, Drejtoria Rajonale e Lindjes, Drejtoria Rajonale Perëndimi dhe Stacioni Policor i Aeroportit.

Stacioni Policor i Aeroportit Ndërkombëtar 'Adem Jashari' në Sllatinë

Ky është i vetmi aeroport civil në Kosovë dhe mbulon momentalisht të gjitha udhëtimet përmes linjave ajrore në Kosovë. Është i vendosur në fshatin Sllatinë, komuna e Lipjanit, përafërsisht 20 kilometra larg nga Prishtina.





Drejtoria Rajonale e Veriut

Kjo drejtori ka në përgjegjësi pikëkalimet kufitare: Merdare, Mutivodë, Jarinje dhe Bërrnjak dhe kontrollimin e zonës kufitare të vijës së gjelbër, në kuadër të këtyre stacioneve. Të gjitha këto pika kufitare janë në kufij me Republikën e Serbisë. Kjo drejtori rajonale ka bazën e saj në Lluzhan të komunës së Podujevës.

Drejtoria Rajonale e Lindjes

Kjo drejtori ka në përgjegjësinë e saj pikëkalimet kufitare: Dheu i Bardhë, Muqibabë, Glloboqicë dhe pikëkalimin kufitar Hani i Elezit. Kjo drejtori ka përgjegjësi kontrollimin e vijës së gjelbër në një pjesë me Republikën e Serbisë dhe pjesën e kufirit me Maqedoninë. Kjo drejtori ka bazën e saj në komunën e Kaçanikut.

Drejtoria Rajonale e Perëndimit

Kjo drejtori është e vendosur në qytetin e Gjakovës dhe mbulon zonën e përgjegjësisë kufitare me Shqipërinë, Malin e Zi dhe një pjesë me Maqedoninë. Ka në përgjegjësinë e saj pikëkalimet kufitare, Vërmicë, Qafë Prush, Qafë Morinë, kalimi në Kullë.

Drejtoria për Operativë

Drejtoria e Operativës së Departamentit të Policisë Kufitare është e vendosur në Prishtinë dhe kryen të gjitha planifikimet dhe vlerësimet operacionale në kuadër të këtij departamenti që ndërliken me Policinë Kufitare.

Drejtoria për Migrim dhe të Huaj

Kjo drejtori punon vazhdimisht në parandalimin e migrimit të paligjshëm në vendin tonë, po ashtu regjistron të gjithë të huajt që paraqiten në Republikën Kosovës dhe kërkojnë lejeqëndrim në Kosovë.

Departamenti për Hetime

DEPARTAMENTI I HETIMEVE – ka për mision parandalimin dhe hetimin e kriminalitetit, zbulimin dhe hetimin e kryerësve të veprave penale, me anë të mbledhjes dhe paraqitjes së fakteve, dëshmive dhe provave, që dëshmojnë fajësinë ose pafajësinë e personave të dyshuar për vepra penale, si dhe vënja e kryerësve të veprave penale para drejtësisë. Fenomenet kriminale me kompleksitet shoqëror siç janë: krimi i organizuar, korrupsioni, krimet e rënda, ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi, kërkojnë qasje shumëdimensionale-disiplinore, prandaj edhe qasja e Departamentit të Hetimeve është shumëdimensionale.

Departamenti i Hetimeve iu kushton fokus të veçantë fuqizimit të kapaciteteve përmes trajnimit të zyrtarëve policorë, avancimit të pajisjeve dhe ngritjes së bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve vendore dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e informatave, bashkimin e lëndëve penale, konfiskimin e aseteve të fituara përmes veprave penale, arrestimin e personave të dyshuar, shkatërrimin e grupeve kriminale si dhe ofrimin e provave organeve të drejtësisë.

Departamenti i Hetimeve punën e bazon në objektivat specifike, si në vijim:

1. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndër-institucional dhe ndërkombëtar;
2. Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, (trafikimit me narkotikë, trafikimit me qenie njerëzore, kontrabandimit me migrantë, kontrabandimit me armë dhe krime kibernetike);
3. Parandalimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, zhvillimi i hetimeve proaktive dhe reaktive;
4. Parandalimi dhe luftimi i krimeve ekonomike, financiare dhe të korrupsionit si dhe;
5. Ngritja e efikasitetit dhe kualitetit në punën hetimore të hetuesve policorë.

Në kuadër të Departamentit të Hetimeve janë të strukturuar:

Divizioni për Hetimin e Krimeve dhe Divizioni Kundër Krimin të Organizuar, si dhe nëntë drejtori. Fokus i veçantë i këtij departamenti janë hetimi i veprave penale të natyrës së krimeve të rënda, krimin të organizuar, krimin ekonomik dhe korrupsionit, krimet kibernetike dhe terrorizmi. Në kuadër të Divizionit për Hetimin e Krimeve bëjnë pjesë:

Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda

Kjo drejtori heton rastet ku kërkohen hetime të specializuara dhe që nuk mund të trajtohen në nivel rajonal apo në nivel të hetimeve të stacioneve.

Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

Kjo drejtori heton të gjitha rastet që ndërlidhen me veprat penale kundër ekonomisë dhe korrupsionit. Fushëveprimi hetimor i kësaj drejtorie ndërlidhet me veprat penale kundër krimeve financiare, keqpërdorimit të detyrës zyrtare, korrupsionit etj.

Drejtoria Kundër Terrorizmit

Kjo drejtori monitoron dhe heton të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me sulmin ndaj rendit juridik të Kosovës dhe terrorizmit.

Drejtoria për Inteligjencë dhe Analizë (DIA)

Kjo drejtori merret me analiza të trendit të krimin dhe furnizon të gjitha njësitë tjera policore me informacione për persona apo grupe të ndryshme kriminale.

Drejtoria e Teknikës Kriminalistike

Kjo drejtori merret me mbledhjen e dëshmive në raste të ndryshme në vendngjarje dhe përgjigjet në rastet kur kërkohet trajtim i rasteve ku nevojitet ekspertiza e krimeve teknike.

Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar

Kjo drejtori heton rastet e krimeve të organizuara dhe njëkohësisht bashkëpunon me të gjitha njësitet tjera policore në hetimin e rasteve të kësaj natyre.

Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë

Heton rastet e trafikimit me substanca narkotike në gjithë territorin e vendit tonë.

Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore

Kjo drejtori heton rastet e trafikimit me qenie njerëzore dhe identifikimin e viktimave të trafikuar.

Drejtoria për Mbështetje të Hetimeve

Kjo drejtori mbështet të gjitha drejtoritë, njësitë tjera policore me informacione dhe plane policore në fushën e lokalizimit të personave që konsiderohen me rrezikshmëri të lartë, që janë në kërkim nga Policia e Kosovës.

Departamenti për Shërbime Mbështetëse

Në kuadër të këtij departamenti bëjnë pjesë: Drejtoria e Teknologjisë Informative, Drejtoria e Logjistikës, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, Drejtoria për Menaxhimin e Objekteve dhe Drejtoria e Prokurimit. Detyrë e këtij departamenti është ofrimi i të gjitha shërbimeve mbështetëse për Policinë e Kosovës, me theks të veçantë ofrimin e qëndrueshëm të të gjitha shërbimeve buxhetore dhe financiare si dhe ato të prokurimeve.

Po ashtu ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës së teknologjisë informative dhe komunikuese, ndërtimin, renovimin dhe mirëmbajtjen e objekteve policore si dhe ofrimin e logjistikës së nevojshme, për të siguruar qëndrueshmëri të aktiviteteve të PK-së.



Departamenti i Burimeve Njerëzore

Detyrë e këtij departamenti është ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve humane të Policisë së Kosovës dhe zhvillimi i tyre përmestrajnimeve, programeve zhvillimore edukative dhe trajnuese, duke përfshirë procesin e rekrutimit, punësimit, trajnimin, zhvillimin, pjesëmarrjen në marrëdhënien e punës, shëndetin dhe sigurinë, trajtimin e drejtë të të punësuarve. Departamenti i burimeve njerëzore kujdeset për mundësitë e barabarta, diversiteti, zhvillimi i karrierës dhe promovimit, identifikimi i nevojave të personelit, administrimi i shënimeve apo të dhënave të personelit, monitorimi i programit të trajnimit praktik për të gjitha nivelet si pjesë e procesit të zhvillimit të karrierës dhe vlerësimit, pushimet dhe mungesat e tjera nga puna, transferimin dhe caktimin në detyrë të personelit policor, dosjet e personelit, disiplinën, largimin dhe dorëheqjet nga puna.





Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit

Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit - ILECU është themeluar në vitin 2011 me vendim të Qeverisë së Kosovës, i përcjellë nga marrëveshja në mes të MPB-së, MD-së, Kryeprokurorit të Shtetit dhe Ministrisë së Financave, ku më pas janë caktuar edhe pikat tona të kontaktit në secilën ministri dhe ky bashkëpunim vazhdon edhe sot.

ILECU në përbërjen dhe organizimin e saj ka INTERPOL, EUROPOL, FAST, PKA dhe ndërlidhësit policorë.

ILECU, në fushëveprimin e saj ka për detyrë


bashkëpunimin policor ndërkombëtar, përmes shkëmbimit të informacioneve, me qëllim parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave penale që ndiqen sipas detyre zyrtare, vende tjera dhe organizata të ndryshme policore, siç janë: INTERPOL, EUROPOL, SELEC dhe rrjete të ndryshme ndërkombëtare, siç janë: ENFAST, FFP, OLAF etj.

Me qëllim ngritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar Kosova deri më tani ka nënshkruar 82 marrëveshje ndërkombëtare që mbulojnë bashkëpunimin policor me 19 shtete dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare.



Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Policia e Kosovës një kujdes mjaft të madh ia ka kushtuar edhe komunikimit me publikun. Në kuadër të PK-së funksionon zyra për informim në nivel qendror, që është e strukturuar në kabinetin e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Po ashtu në kuadër të secilës drejtori rajonale funksionojnë zyrat për informim në nivel rajonal. Detyrë kryesore e zyrës për informim është komunikimi me opinionin përmes mediave, duke informuar publikun për aktivitetet e Policisë dhe gjendjen e sigurisë në vend. Zyra qendrore mbulon aktivitetin e Policisë së përgjithshme dhe aktivitetet ku përfshihen dy ose më shumë drejtori rajonale, ndërsa zyrat rajonale mbulojnë aktivitetin e drejtorisë rajonale përkatëse. Falë punës së zyrave për informim të Policisë e Kosovës disa herë është shpallur si institucioni më transparent dhe zyrtarët për informim janë shpërblyer me çmimin ‘zëdhënësi më i mirë në Kosovë’.





Katalogu i uniformave zyrtare të Policisë së Republikës së Kosovës

Prishtinë, 2019



**NJËSITI
PATROLLUES**



**POLICIA E TRAFIKUT
RRUGOR**



**NJËSIA SPECIALE PËR TRAJTIMIN
E MJETEVE TË IMPROVIZUARA
EKSPLOZIVE**



**NJESIA E
BICIKLISTAVE**





NJËSIA K-9 E POLICISË SË KOSOVËS



NJËSIA E MOTOÇIKLISTËVE



GARDA E NDERIT



UNIFORMA SOLEMNE





NJËSIA SPECIALE
PËR OPERACIONE



NJËSIA SPECIALE
PËR OPERACIONE



NJËSIA SPECIALE
INTERVENUESE



NJËSIA SPECIALE
INTERVENUESE



Policia e Kosovës



Kontakto / Contact / Kontakt POLICINË E KOSOVËS

Nga telefonia fikse dhe mobile / Od linije mobilni linije / From the fixed line By mobile:



Ju mund të dërgoni informatat e juaja edhe në adresën elektronike/ Takođe možete da pošaljete svoje podatke na e-mail adresu/ You can also send your information to the email address: info@kosovopolice.com

192 038 550 999

080019999

Të gjitha thirrjet në numrin 080019999 janë anonime, pa pagesë dhe konfidenciale
Svi pozivi su anonimni broj 080019999 , bespлатan i poverljiv/ All calls are anonymous number 080019999, free and confidential